

VENDIM
Nr. 33, datë 9.6.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 3.6.2014, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 27 Akti, që i përket:

KËRKUES: Nazmi Luku

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës, shoqëria e përmbarimit “EPSA” sh.p.k.

OBJEKTI: Ndrejje gabimi në vendimin nr. 16, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 80 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes, Gani Dizdari, shqyrtoi kërkesën e paraqitur dhe diskutoi çështjen në tërësi:

VËREN:

I

1. Kërkuesi Nazmi Luku i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, me objekt: “Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit të formës së prerë nr. 81, datë 18.6.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë”.

2. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 16, datë 21.3.2014, ka vendosur: “Konstatimin e cenimit të së

drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 81, datë 18.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

3. Pas zbardhjes së vendimit, kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, me objekt: “Ndrejje gabimi në shkrim në dispozitivin e vendimit nr.16, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese, duke zëvendësuar fjalët “të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë” me fjalët “të Gjykatës së Apelit Tiranë””.

II

Gjykata Kushtetuese, pasi administroi vendimin e saj nr. 16, datë 21.3.2014, konstaton se është bërë një gabim material dhe konkretisht: në dispozitivin e vendimit në vend të fjalëve “të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë” duhej të ishte shkruar “të Gjykatës së Apelit Tiranë”.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,
VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Ndrejjen e gabimit në dispozitivin e vendimit nr. 16, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese, si vijon:

- Në dispozitiv, në vend të “vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 81, datë 18.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, do të jetë “vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 81, datë 18.6.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë”.

- Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit nr. 16, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

